



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 38 213-722
Fax:: +381 38 213-990
e-mail: kaaoffice@gmail.com
web: www.akreditimi-ks.org

Nr. 510113 dt. 08.07.2013

Në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr. 03/L-189), Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 04/L-037), neni 7 (pika 2.3 dhe pika 4), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e BPrAL (nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e AKA-së (nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 02/2013), në Udhëzimin Administrativ për Kriteret dhe Procedurën e Akreditimit të Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (nr. 12/2009), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka shqyrtuar raportet e ekspertëve të vlerësimit dhe në bazë të rekomandimeve, në mbledhjen e mbajtur më 3 Korrik 2013, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohet Kolegji “Pjeter Budi” në nivel institucional për një periudhë 3 vjeçare (1 Tetor 2013 – 30 Shtator 2016).

II. Programet e studimit:

- Dogana dhe Shpedicion (BA) R
- Turizëm dhe Hotelieri (BA) R
- Menaxhment (MA) – (me specializimet në Sigurime; Turizëm dhe Hotelieri) R

akreditohen për një periudhë 3 vjeçare (1 Tetor 2013- 30 Shtator 2016).

III. Programet e studimit:

- Ekonomik (BA) A
 - Menaxhment dhe Informatikë (BA) A
- nuk akreditohen.

IV. Për shkak të vërejtjeve të shumta në çështjet institucionale të bëra nga Ekipi i Ekspertëve, KSHC ka marr vendim për akreditim institucional më të shkurtër se sa periudha e plotë, për një periudhë 3 vjeçare. KSHC shpreh brengën për shkak të rënies së cilësisë në institucionin tuaj. Prandaj ju lutemi të merrni parasysh rekomandimet e bëra nga Ekipi i Ekspertëve gjerë në periudhën e ardhshme të akreditimit.

V. Institucioni i juaj është i obliguar që të hartojë një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve (në të dy gjuhët dhe në të dy versionet) dhe të njëjtin ta dorëzoni në Agjencinë e Kosovës për Akreditim gjer më 1 Dhjetor 2013.

VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ferdije Zhushi Etemi, kryetare
Këshilli Shtetëror i Cilësisë

